



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 20.11.2018

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

PËR

**SHQYRTIMIN NË PARIM TË PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”.**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet datave 6.11.2018; 8.11.2018 dhe 20.11.2018, mori në shqyrtim në parim, projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 dhe 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale së bashku me projektligjet e tjera financiare që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Ervin Bushati.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1 dhe 155, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, jep një kontribut të shtuar, në kuadër të gjithë reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, me qëllim mbështetjen të prodhimit vendas, përmes lehtësimit të kostove të prodhimit, kryesisht në sektorin bujqësor dhe në atë të përpunimit të mallrave jo shqiptare me destinacion eksportin (industria fason). Gjithashtu politika stimuluese parashikohen edhe me qëllim reduktimin e ndotjes së mjedisit etj.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, propozon konkretisht sa më poshtë:

- Në nenin 1 të projektligjit propozohet shtimi i 2 pikave të reja në nenin 49 të ligjit bazë, duke mundësuar:
 - Nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e digjitalizimit të mediave audiovizive, përmes aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH në nivelin 6%, për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive (televizionet). Përmes kësaj politike vlerësohet se do të stimulohen dhe lehtësohen investimet në kuadër të digjitalizimit të mediave audiovizive (televizionet).
 - Nxitjen dhe zhvillimin e “transportit publik të gjelbër” pra transportit eko-miqësor, që nuk ka ndikim negativ në mjedis, duke propozuar aplikimin e një shkalle të reduktuar të TVSH në nivelin 10 %, për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobus me dhjetë vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik. Kjo politikë vlerësohet se do të ndikojë në stimulimin e zëvendësimit të autobusëve me naftë me autobuzë elektrik.
- Në nenet 2 dhe 3 të projektligjit parashikohen lehtësi për prodhimin vendas, përmes:
 - Mbështetjes së sektorit bujqësor, nëpërmjet lehtësimit të kostove të investimit, duke përfshirë në kategorinë e veprimtarive me interes të përgjithshëm, të përjashtuar nga TVSH-ja edhe atë të furnizimit të makinave bujqësore, i cili aktualisht është furnizim i përjashtuar vetëm në import.

- Përfshirjen në listën e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja, edhe të nënkontraktorëve/nën operatorëve të shoqërive mbajtëse të autorizimeve të përpunim aktiv, (të quajtura industria “fason”), të cilat, nënkontraktohen për kryerjen e një ose disa operacioneve përpunuese. Në këtë mënyrë unifikohet trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, si për operatorin ekonomik që mban autorizimin e përpunimit aktiv ashtu edhe për nënkontraktorin e tij.
- Neni 4 të projektligjit, shton një dispozitë të re stimuluese në zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, përmes uljes së kostos së prodhimit, duke përfshirë si përjashtime të veçanta në import edhe importimin e lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave me përjashtim të lëndëve të para me përdorim të dyfishtë.

IV. Efekti Financiar

Për shkak të shtimit të lehtësirave fiskalë që ky projektligj synon të mundësojë, parashikohet të ketë një efekt buxhetor, që përafërsisht vlerësohen në masën minus 300 000 000 (treqind milionë) lekë, por që vlerësohet të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që stimulohen dhe lehtësohen.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, bëri një prezantim të detajuar të gjithë risive dhe parashikimeve konkrete të projektligjit dhe vlerësoi impaktin pozitiv dhe stimulues që ai do të sjellë kryesisht në sektorin e bujqësisë por dhe në prodhimin vendas në përgjithësi.

Gjithashtu, relatori theksoi faktin se, megjithëse e vlerëson tejet pozitive iniciativën për mbështetjen e sektorit bujqësor, duke përfshirë në kategorinë e veprimtarive me interes të përgjithshëm, të përjashtuar nga TVSH-ja edhe atë të furnizimit të makinave bujqësore, i cili aktualisht është furnizim i përjashtuar vetëm në import, por sugjeroi që duke marrë parasysh faktin e mbështetjes që po jepet për bujqësinë, që përbën një nga sektorët kryesorë të ekonomisë, të shikohet me kujdes zbatimi konkret i angazhimeve të ndërmarra ndër vite në këtë sektor, përmes uljes së TVSH-së për të gjitha inputet bujqësore në import dhe në transaksionet e brendshme.

Ky propozim u mbështet edhe nga anëtarë të tjerë të komisionit, të cilët theksuan nevojën për stimulim të mëtejshëm të bujqësisë, përmes përjashtimit apo reduktimit të shkallës së TVSH-së, të të gjithë inputeve bujqësore (plerave kimike, pesticide, farërat etj.) masa këto që do të kenë një impakt direkt tek fermerët dhe blegtorët përmes uljes së kostove të prodhimit dhe rritjes së produktivitetit. Gjithashtu u vlerësua nevoja për një politikë diferencuese ndërmjet

inputeve bujqësore të sipërcituara nga stimulantët për të cilët duhet të ketë politikë kufizuese dhe diferencuese taksimi.

Në komision u diskutua, propozimi që sjell projektligji, për reduktimin e TVSH për reklamat në mediat audiovizive, me fokus evidentimin e industrive të tjera, që ndeshen me problematika të njëjta dhe që mund të trajtohen gjithashtu në mënyrë specifike si “libri”, për të cilin ka një handicap për shkak të aplikimit të TVSH për të 20% në blerje dhe zero % në shitje. Për këtë qëllim, gjatë diskutimit nen për nen do të rivlerësohet mundësimi i aplikimit të TVSH-së së barabartë me qëllim që të mos krijohet kosto gjatë aplikimit të kësaj mase në aktivitetin e botimit dhe tregtimit të librave.

Një aspekt tjetër që u diskutua nga anëtarët e komisionit, lidhet me politikën për ekonominë e gjelbër, duke u evidentuar nevoja për thellimin e politikës së ndërmarrë, përmes uljes akoma më shumë të shkallës së reduktuar të TVSH-së për këtë kategori, me qëllimin stimulimin e përdorimit të mjeteve elektrike të transportit publik, por gjithashtu shtrirjen e saj edhe më të gjerë si p.sh. tek taksitë, për shkak të nevojës jetike për reduktimin e nivelit të ndotjes në vend si pasojë e përdorimit të karburantit fosil.

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat duke e vlerësuar këtë projektligj, një paketë lehtësuese për biznesin e prodhimit vendas dhe të biznesit në përgjithësi e miratoi në parim projektligjin, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATOR

Ervin BUSHATI

KRYETAR

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë më 27.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR
(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 26 dhe 27 nëntor 2017, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Projektligji është pjesë e paketës së projektligjeve financiare që shoqërojnë projektbuxhetin 2019.

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi u zhvillua pas miratimit në parim të këtij projektligji në seancën plenare të datës 22 nëntor 2017. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi këtë projektligj bazuar në nenet 32-38 si dhe nenet 80 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 26 nëntor ishin të pranishëm përfaqësues nga shoqatat e biznesit si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri, *Dhoma Gjermane e Tregtisë* dhe Industrisë në Shqipëri dhe Biznes Albania. Ndërsa, në mbledhjen e datës 27 nëntor ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

Ndër ndryshimet dhe shtesat kryesore të propozuara nga Këshilli i Ministrave në legjisllacionin e tatimit mbi vlerën e shtuar, përmendim:

- Nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e digjitalizimit të mediave audiovizive, përmes aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH në nivelin 6%, për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive
- Nxitjen dhe zhvillimin e “transportit publik të gjelbër” duke propozuar aplikimin e një shkalle të reduktuar të TVSH në nivelin 10 %, për furnizimin e mjeteve të transportit

publik të udhëtarëve me autobus me dhjetë vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik.

- Mbështetjen e sektorit bujqësor, nëpërmjet lehtësimit të kostove të investimit, duke përfshirë në kategorinë e veprimtarive me interes të përgjithshëm, të përjashtuar nga TVSH-ja edhe atë të furnizimit të makinave bujqësore, i cili aktualisht është furnizim i përjashtuar vetëm në import.
- Përfshirjen në listën e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja, edhe të nënkontraktorëve, të cilët nënkontraktohen për kryerjen e një ose disa operacioneve përpunuese.
- Përjashtimin nga pagesa e TVSH-së në import të lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave me përjashtim të lëndëve të para me përdorim të dyfishtë.

Për shkak të shtimit të lehtësirave fiskale që ky projektligj synon të mundësojë, parashikohet të ketë një efekt buxhetor në masën minus 300 000 000 lekë, por nga ana tjetër ndryshimet vlerësohet të sjellin efekte pozitive për zhvillimin e sektorëve që stimulohen dhe lehtësohen.

Gjatë diskutimeve në Komision përfaqësues të shoqatave të biznesit përshëndetën ndryshimet në këtë projektligj, për zgjerimin e mëtejshmëm si të skemës së përjashtimit nga pagesa e TVSH-, për sektorë të veçantë të biznesit, ashtu edhe të aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së në sektorin e medias audiovizive dhe transportin e gjelbër. Megjithatë, përfaqësues të disa shoqatave i sugjerojnë Komisionit aplikimin e shkallës 0% të TVSH-së, jo vetëm për subjektet e autorizuar nën regjimin e përpunimit aktiv, por edhe për nënkontraktorët e tyre, rishikimin e përjashtimit për furnizimin e librit dhe rishikimin e skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë bashkë me përjashtimin e TVSH-së për të gjitha inputet bujqësore në import dhe në transaksionet e brendshme.

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni mbasi mori në shqyrtim raportet e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, e miratoi projektligjin nën për nen dhe në terësi me 10 vota pro dhe një votë kundër, me ndryshimet e mëposhtme:

- Në nenin 1, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 7, riformulohet me këtë përmbajtje:

“7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizime mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind deri në datën 31 dhjetor 2021. Nga data 1 janar 2022 shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar që aplikohet për këtë furnizim është 10 për qind”.

2. Pas pikës 7, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

“8. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e librave të çdo lloji është 6 për qind.”

- Neni 2, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 2

Në nenin 51 “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm”, pas shkronjës “m” shtohen shkronjat “n”, “o” dhe “p”, me këtë përmbajtje:

n) Furnizimi i makinave bujqësore. Lista e makinave bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

o) Furnizimi i inputeve bujqësore siç janë plehrat kimikë, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të NKM-së. Lista e kategorive të imputeve bujqësore përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

p) Furnizimi i shërbimeve veterinare, me përjashtim të shërbimeve veterinare për kafshët shtëpiake.”

- Në nenin 3, pika 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Në shkronjën “j” fjalët “...dhe i librave...” “...dhe nga media elektronike ...” hiqen.

- Pas nenit 4, shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Në nenin 148 “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, fjalët “...20 për qind” zëvendësohen me fjalët “... 6 për qind...”.

RELATOR

KRYETARI

Ervin BUSHATI

Erjon BRAÇE